



Ky projektfinancohet nga Bashkimi Evropian



## NJOFTIM

UN Women në bashkëpunim me Bashkinë Gramsh, në kuadër të projektit të përbashkët “Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri”, financuar nga Bashkimi Evropian përmes Fondit të Përshejtimit të Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm për Shqipërinë, po zbaton një ndërhyrje për mbështetjen ekonomike dhe fuqizimin e grave në Bashkinë Gramsh në fushën e bletarisë dhe bimëve aromatike dhe mjekësore.

Kjo ndërhyrje ka fokusin kryesor të mbështesë gratë prodhuese dhe fermere, të cilat janë pa mbështetje të tjera financiare apo në vështirësi ekonomike, dhe kanë dëshirë të angazhohen në fushat e sipërpërmendura.

Ky aktivitet do të krijojë mundësinë e të punuarit së bashku duke siguruar zhvillimin e mëtejshëm të zinxhirëve të vlerës së Mjaltit dhe Bimëve Mjekësore dhe Aromatike, përmirësimin e proceseve të punës, rritjen e cilësisë, diferencimin dhe promovimin në treg të produkteve përfundimtare.

Në këtë kuadër, ju inkurajojmë të aplikoni për t’u bërë pjesë e këtij aktiviteti dhe për të punuar së bashku.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni: Ergent Pire: 0682096130, Menaxheri i Projektit dhe perfaqesues i kompanisë zbatuese të projektit “CBS” ose të drejtoheni në zyrën e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Gramsh (kontakt: 0699120128), për të regjistruar interesin tuaj, brenda datës 10 Qershor 2022.

Ju mirëpresim të bashkëpunojmë së bashku për të fuqizuar gratë në zonat rurale!

---

Ndërhyrja FUQIZIM EKONOMIK I GRAVE NË ZINXHIRËT E VLERËS TË MJALTIT DHE BIMËVE MJEKËSORE DHE AROMATIKE NË BASHKINË GRAMSH zbatohet nga “Creative Business Solutions - CBS” në kuadër të Projektit “Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore (EU4GE)”, mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UN Women.

Kontakt CBS: [ergent.pire@cbs.al](mailto:ergent.pire@cbs.al)